



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 339/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Zoran Rakiq- bartës i listës nga radhët e G.I. Sprska, në Vushtrri, paraqitur kundër Komisioni Komunal Zgjedhor, në Vushtrri, për shkak nominimit të Anëtarëve të Këshillave të Vendotimeve, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si i palejueshëm apeli i Zoran Rakiq- bartës i listës nga radhët G.I.Srpska, parashtruar kundër nominimit të anëtarëve të KVV-ve.

**Arsyetim**

Më datë 24.10.2013, PZAP-i ka pranuar një apel nga bartësi i listës G.I.Srpska në Vushtrri, në të cilin thekson se KKZ, në Vushtrri, ka kërkuar nga G.I.S. që të përpiloj listën për 6 anëtarë të KVV-ve, gjë të cilën e kanë bërë në afatin ligjor. Mirëpo, anëtarët e Iniciativës Qytetare GIS nuk janë pranuar si anëtarë të KKZ-së në Vushtrri dhe për këtë parashtruesi i apelin mendon se është bërë diskriminim nga ana e kryetarit të KKZsë Bekim Xhema dhe anëtarit Boban Ristiç.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, dhe gjeti se:

**apeli është e palejuar**

Ankuesi në apelin e tij pretendon se nominimet e anëtarëve të KVV, në Komunën e Vushtrrisë janë bërë diskriminime ndaj anëtarit të GIS-së Zoran Rakiq. PZAP-i konstaton se këto pretendime ankimore nuk janë në juridiksionin e këtij institucioni për të vendosur sipas nenit 122.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) ngase PZAP-i, vendos vetëm për disa vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht me dispozitën e sipërshtuar, meqenëse pretendimet ankimore nuk janë në përputhje me dispozitën e lart theksuar PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 339/2013 më datën 31.10.2013

A nr. 339/2013 më datën 31.10.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** *PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*